



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më 18.06.2019 (martë) duke filluar në ora 10:00.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2020-2022;
3. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:11.06.2019
Në: Novobërdë



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic

(H. Arsic)



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e pestë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 21.05.2019, duke filluar në orën 10:15. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Anëtarët e KPF-së: Nebojsa Arsic, Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Xhejlane Behluli, Selatin Nuhiu, Nënkryetari i Komunës Sinisa Dimic, Drejtori i Urbanizmi dhe Katastrit Bojan Peric, Drejtori i Bujqësisë Sllobodan Pavic, D.SH.P Shefkije Mehmeeti, Drejtori i Administratës Driton Abdyli, ZBPZHR Avdi Vllasaliu, Kryesuesja e komiteti për komunitete Shpresa Kqiku dhe perfaqësuesi i OSBE-së.

Kryesuesi pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës duhet konstatuar kuorumin prezentë janë të gjithë antarët e KPF-së pas kësaj e hapi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Raportimi i Komisionit për dhënjen e tokës Komunale në Shfrytëzim;
3. Shqyrtimi i propozimit për dhënie afatshkurtër të vendgjahishtës së Komunës së Novobërdës;
4. Propozim Vendimi për Formimin e KKS-së;
5. Draft Plani Aksional i Komunes për efqenc të energjisë (PAKEE);
6. Propozimi për percaktimin e automjetve të vjetra Komunale që janë jashtë përdorimit;
7. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit a pajtohen me rend dite?
Kryesuesja e komiteti për komunitete Shpresa Kqiku pasi përshëndeti të pranishmit tha: i kam dy kërkesa prej mbledhjes së fundit të komiteti për komunitete që të shkojnë në rend dite në Kuvend, pika e parë është pse nuk janë kyçur të gjithë ujsellësat në teritorin e Komunës së Novobërdës në Kompanin regjionale Hidromorava dhe pika e dytë mosfunksionimi i sistemit të ndriqimit publik në gjithë teritorin e Komunës së Novobërdës.

Kryesuesi tha: kush është për aprovimin e propozimit të parë?

Aprovohet njëzëri kjo pikë që të hyj në rend dite.

Pastaj pyeti se kush është për aprovimin e pikës së dytë?

Aprovohet njëzëri kjo pikë që të hyj në rend dite.

Pasi nuk pati propozime tjera aprovohet njëzëri rendi i ditës me këto dy pika shtesë të propozuara:

1. Informat rreth mos kyçjes të të gjithë ujëjellësve egzistues në Komunën e Novobërdës në kompanin regjionale Hidromorava;

2. Informat rreth mos mirëmbajtjes dhe funksionalizimit të të gjithë simeve të ndriqimit publik egzistues në Komunën e Novobërdës;

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;

Kryesuesi tha: ju kërkoj falje që procesverbali në gjuhën serbe ju ka arritur me vonë.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime procesverbali u aprovua me 4 vota për dhe 1 apstenim nga antarët e KPF-së.

Pika e dytë: Raportimi i Komisionit për dhënjen e tokës Komunale në Shfrytëzim;

Për këtë pikë Kryesusi ja dha fjalën Drejtorit të Urbanizimit dhe Katastrit Bojan Peric.

Bojan Peric pasi pershendeti të pranishmit tha: jam emruar prej shtatorit të vitit të kaluar Drejtor dhe mundë të them se prej asaj dite që jam emruar unë drejtor asnjë ari tokë nuk e kemi dhënë në shfrytëzim dhe se kam nënshkruar asnjë kontratë a kan dhënë më heret unë nuk e di, ju kisha lut se a keni pas më heret raport si dhe nese bënë të kem listen se kush është antar i atij komisioni.

Kryesusi tha: para se të bihet ky ligj që është në fuqi tani, Kuvendi ka pasur të drejt të jep tok në shfrytëzim në bazë të kërkeses dhe kërkesat ju kan drejtuar Kuvendit Komunal nders ne ja kemi drejtuar kërkesat komisionit adekuat, duke pasur parasysh që ka kërkesa kemi kerkuar raport se çka është punuar në lidhje me ato kërkesa.

Bojan Peric tha: sa i përket kësaj kërkesa a janë derguar apo jo, ne gabimisht na ka ardh një kërkes nga agjensioni i pylltarisë për dhënjen e tokave dhe ka dal se është tokë e Komunës, andaj nuk mund ne si Drejtori të vendosim por do tju dergojm ju si Kuvend dhe ju pastaj ti ndermerrni masat e tjera.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli pasi pershendeti të pranishmit tha: po nderlidhem me komisionin në fillim kur është formuar prej LDK-së ka qenë Xhevat Mehmeti i cili është zgjedhur Kryetar i Komisionit, në momentin që është zgjedh Drejtor është liruar ai vend dhe nuk është emruar askush në at komision prej LDK-së, sa ka qenë në komision kanë qenë dy kërkesa prej Kryetarit të Komisionit për dhënje të tokes në shfrytëzim në Kuvend, pasi që përfaqësoj LDK votoj kunder kësaj pike që të dergohet në Kuvend pasi që nuk ka asnjë përfaqësues nga partia jonë.

Kryesusi tha: po nderlidhem me diskutimin e Xhejlanes, mendoj se antarët e komisioni se kush është antarë i komisioni nuk ka lidhje me parti politike, ndërsa kërkesat që i permende ti për ndarjen e parcelave për nderimin e shtpisë në Pasjak që i ka prezantu edhe Xhevati në Kuvend por edhe pse këto kërkesa kan ardh në Kuvend, Kuvendi nuk ka të drejt të votoj për ose kunder por duhet komisioni ti vazhdoj procedurat.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: sa i përket ksaj pike edhe unë jamë pjesë e këtij komisioni që jam zgjedhur nga Kuvendi, edhe Xhejlanja është zavendesuar me Xhevatin por kryetare e komisionit nuk është por antare e komisionit po, ne kerkojm prej Drejtoris përkatëse identifikimin e pronave Komunale, sa prona janë dhënë deri tani në shfrytëzim?, sa janë në dispozicion?, sa paguajn qira ato prona?, dhe është mirë mos të nënglizhohen antarët e komisionit nga Kuvendi, jam për kësaj pike që të dergohet në Kuvend dhe Drejtori të pregadit raport rreth identifikimim të pronave Komunale në mënyrë të detajuar.

Xhejlane Behluli tha: e perkrahi me shku në Kuvend nese edhe njëher e zgjedhim personi e partisë tonë antarë të këtij komisioni pasi që atëher nuk kanë qenë dy antarët e rinjë në Kuvend, pra mendoj se edhe njëher duhet të diskutohet formimi i këtij komisioni.

Bojan Peric tha: e keni cek raportin i komisionit, akeni ndonjë antarë të komisionit i cili mundet të na raportoj, pasi që paska antarë të komisionit sigurisht që e din se a kanë dhënë tokë apo jo, antari i komisionit e din se kush paguan e kush jo.

Selatin Nuhiu tha: u mundova të sqarohem me Drejtorin se prej shtatorit të vitit të kaluar në si komision nuk kemi dhënë asnjë pronë Komunale pasi që ky komision nuk ak funksionuar, ne vetem një takim e kemi mbajtur ku është zgjedhur kryetari i komisionit, nese ky komison nuk ka dhënë prona Komunale në shfrytëzim, komisioni më heret po pasi që i shohim në raport financiar se dikush po paguan qira nga prona Komunale.

Bojan Peric tha: unë thash se Drejtoria e Urbanizimit nuk mundet të jap raport se kush e paguan qiran e kush nuk e paguan, nese ai komision nuk është funksional le të zgjedhet një komision më antarë të rinjë.

Avdi Vllasaliu tha: pasi që kemi edhe tokë bujqësore në ata komison të jetë edhe një antarë nga Drejtoria e Bujqësisë.

Bojan Peric tha: sa i perket meje jam kunder që kjo pikë të shkoj në Kuvend, lë të zgjidhen këto probelem njëher e pastaj diskutojm.

Selatin Nuhiu tha: po ja kujtoj Drejtorit edhe njëher se nese nuk është detyr e tij që të raportoj atëher nuk e di se kush do të raportoj për pronat Komunale në shfrytëzim, ne jemi formu si komision por Drejtori është duhur të na ftoj ne si komision pasi që komisioni ka perfshirje edhe nga ekzekutivi dhe nga Kuvendi.

Bojan Peric tha: në një pjesë ke të drejtë, por ju e keni formuar komisioni dhe ju nga ata duhet të kerkoni pergjegjësi.

Kryesusi tha: komisioni perbëhet nga 7 antarë, 3 nga Kuvendi dhe 4 nga kshilli ekzekutiv, 1 nga ata ka qenë Drejtori i Urbanizmit.

Bojan Peric tha: nuk është problem unë do të bisedoj në antarët e komisionit dhe do të raportojm.

Pasi nuk pat diskutime tjera aprovohet me 3 vota për dhe 2 kunder (Xhejlane Bheluli, Milica Jovanovic) nga antarët e KPF-së kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

Pika e tretë: Shqyrtimi i propozimit për dhënjë afatshkurtër të vendgjahishtës së Komunës së Novobërdës;

Kryesuesi për këtë pikë ja dha fjalën ZBPZHR Avdi Vllasaliut.

Avdi Vllasaliu pasi pershendeti të pranishmit tha: tju njoftoj se tash e kemi edhe Drejtorin e Bujqësisë sa i perket pikes do ta prezantoj unë pasi që Drejtori është i ri dhe nuk e din se si kanë shkuar proceduart më heret. Kjo pikë ka qenë edhe në mbledhjen e kaluar, dhe ne jemi të interesuar që në Kuvend ta marrmi pelqimin për dhënjë në menaxhim të vendgjuetisë, pasi të mirret pelqimi atëher të formohet komisioni prej 5 antarëve, dy të jenë nga Kuvendi dhe 3 nga ekzekutivi, sa i perket materilait e kan materialin e muajit të kaluar.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Milica Jovanovic tha: këtë pikë mos ta dergojm në Kuvend si heren e fundit që e patem në rend dite dhe nuk ishte askush që ta prezantoj.

Avdi Vllasaliu tha: kërkoj falje por kam qenë jashtë vendit.

Xhejlane Behluli tha: pasi që të formohet komisioni të jepet pelqimi personit qe do ta merr në shfrytëzim a duhet të raportoj kujt ju është dhënë?.

Avdi Vllasaliu tha: po ai komision e dergon në Kuvend dhe çmimi më i lartë zgjedhet.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 2 vota për 3 kunder (Nebojsa Arsic, Milica Jovanovic, Mirjana Simijonovic) nuk aprovohet nga antarët e KPF-së kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

Pika e katërtë: Propozim Vendimi për Formimin e KKSBB-së;

Për këtë pikë Kryesusi ja dha fjalën Nënkryetarit të Komunës Sinisa Dimic.

Sinsa Dimic pasi pershendeti të pranishmit tha: e dini se edhe në heren e kaluar e kemi derguar kte propozim vendim por keni kerkuar që të ndryshohet zyratri i arsimit ne e kemi bërë e kemi vendosur Drejtorin e arsimit, kemi biseduar disa here rreth këtij komisioni dhe e dim se është shumë i rendesishëm për sigurin e qytetarëve të Komunës tonë.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu tha: kemi diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar të Kuvendit dhe kjo pikë nuk mundë të kaloj pasi që nuk e dim se si do të paguhen këta njerëz, duke u bazuar se në komitetin e kaluar antarëve të këtij komiteti ju ka mbetur borgj.

Perfaqësuesi i OSBE-së Edmon Hyseni pasi pershendeti të pranishmit tha: këtë pikë edhe ne si OSBE ju lusim që ta fusni në rend dite për Kuvend sepse është shumë e rendesishme, ju mundë të diskutoni për antarët nese keni ndonjë kundershtrim por jo për komisionin, siç e dini kohëve të fundit keni pasur incidente të shumta dhe Komuna ka persion që të nermër diçkanë lidhje me këtë, sa i perket meditjeve nuk e ndalin punën e themelimit të këtij komisioni sepse ne llogarisim që më mirë është të themelohet ky komision se sa te diskutohet dhe anulohet per arsye se dikush më heret nuk i ka marrë meditjet. Ky propozim mundet edhe drejt me shku në Kuvend por për hir të transparences e kan sjell edhe në KPF që të diskutojn së bashku më ju.

Selatin Nuhiu tha: transparenc nuk ka fare këtu, sipas mendimit tim perseri do të shkoj si në mandatine kaluar, nuk do të paguhen antarët dhe do të perseriten gjërat e njejtja, sa i perket emrave kemi vërejtje të shumta pasi që ka njerz qe nuk duhet të jenë në këtë komitete se nenkryetarët e Komunës, andaj propozoj qe kjo pikë të mos shkoj në Kuvend.

Pasi nuk pati diskutime me 1 vot për dhe 4 kunder nuk aprovohet nga antarët e KPF-së kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

Pika e pestë: Draft Plani Aksional i Komunes për efqenc të energjisë (PAKEE);

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalën D.SH.P Shefkije Mehmeti.

Shefkije Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: ky është një draft plan që e kanë të gjithë Komunitetet e Kosovës dhe kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për mbeshtetje të efikasitetit të energjisë për burime të ndryshme. Ky plan aksional i efikasitetit të energjisë është për vitet 2018-2020, këtë draft plan e kanë pregaditur BE, ne e kemi pasur për obligim përthimin dhe të dhënat e Komunitetit për të hyrat, sa kemi ndertesa, sa kemi shpenzime të energjisë, sa vendbanime etj.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime aprovohet njëzëri nga antarët e KPF-së kjo pikë që të shkojë në Kuvend.

Pika e gjashtë: Propozimi për percaktimin e automjeteve të vjetra Komunitetale që janë jashtë përdorimit;

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalën Drejtorit të Administratës Driton Abdylit.

Driton Abdylit pasi pershendeti të pranishmit tha: me material e kemi një vendim nga ana dhe një raport nga komisioni për vlerësim të automjeteve, iniciativa ka ardhur nga Kryetari i Komunitetit me rekomandimin e auditorit i përgjithshëm, mandej është formuar komisioni i cili ka pasur për detyrë vlerësimin e gjendjes së automjeteve në mënyrë që të dimë se cilat automjete janë jashtë përdorimit dhe ti shesmi, në bazë të raportit të vlerësimit kanë konstatuar se 11 automjete janë jashtë përdorimit, e kanë pershkuruar gjendjen e tyre, kanë mbajtur procesverbale, por pika nuk është e formuluar mirë pasi që Kuvendi duhet të marrë vendim për shitje të këtyre automjeteve.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu tha: është pikë e mirë pasi që ka shumë automjete që rrin në parking të Komunitetit, këto automjete le të shiten dhe të pastrohen, por e kam një pyetje se si parashihen të shiten këto automjete me ankand publik apo si?

Driton Abdylit tha: vendimi është i brendshëm, sipas verifikimit numri i automjeteve perputhet me numrin në qendren e regjistrimit të automjeteve, ne me këtë vendim kërkojmë nga Kuvendi që të na lejojë shitjen e këtyre automjeteve. Mënyra më e mirë për shitje është me ja dhënë shpisë së ankandit për shitje.

Pasi nuk pati diskutime aprovohet njëzëri nga antarët e KPF-së kjo pikë që të shkojë në Kuvend.

Pika e shtatë: Informatat rreth moskësjes të të gjithë ujëjellësve egjistues në Komunitetin e Novobërdës në memorandum të nënshkruar në mes të Komunitetit të Novobërdës dhe Kompanisë Regjinale Hidromorava;

Kryesuesi i pyeti se kush është për që këto pika të shkojnë në Kuvend.

Aprovohet njëzëri nga antarët e KPF-së kjo pikë që të shkojë në Kuvend.

Pika e tetë: Informatat rreth mos mirëmbajtjes dhe funksionalizimit të të gjithë sistemeve të ndriqimit publik egjistues në Komunitetin e Novobërdës;

Kryesuesi i pyeti se kush është për që këto pika të shkojnë në Kuvend.

Aprovohet njëzëri nga antarët e KPF-së kjo pikë që të shkojë në Kuvend.

Pika e nëntë: Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Procesëmbajtëse
Valmire Mustafa



Kryesuesi i Kuvendit

Nebojsa Arsic

